

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rruga Milot-Balldren, sërish hija e Ballukut në tenderin 365 milionë euro, fitues kompania nën hetim nga SPAK
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/rruga-milot-balldren-serish-hija-e-ballukut-ne-tenderin-365-milione-e-i104911
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 18:41:48 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 18:32:02 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5a5fa229955a67a0b187eec2d15f56241092bd7b6bba77b890f42607f8a7db4d
TEKSTI	cf90dd83cd01bbae99dbfe6d5e79ea27b24456fb9ec498b102cc22e968c9cc83
PAMJA	941da7ec7e63e7684c78c394963d54f8293ef74ff14bb55b049e0e2b47f4b70a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	59750ecef124f6da8868ed51d6624650a4f1c8cc0533eab8a1792b82982be05e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	214493168e8eaddb39b9693f5adfa0b73b0dd908a9438af0217b4721b8b2f352
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/59750ecef124f6da8868ed51d6624650a4f1c8cc0533eab8a1792b82982be05e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **tenderin 365** parashikuar e koncesionit ■ **rinjtë shqiptarë** Gjirokastra te Athinës, ku humbën ■ **SPAK ende pa asnjë** reaguar lidhur me mungesën e një kërkesë ■ **Burgu është rruga jote,** mbremje në Tiranë, duke shënuar ditën e 111 ■ **Vlora t'u gjet** me një zbulim të pazakontë...

AKTUALITET

Rruga Milot-Balldren, sërish hija e Ballukut në tenderin 365 milionë euro, fitues kompania nën hetim nga SPAK

Piranjat Përditësimi i fundit 18 Shtator 2026, 20:32



Rreth 365 milionë euro për 35 vjet. Kjo është vlera e parashikuar e koncesionit Milot-Balldren, rruga 17 kilometra e gjatë që do të ndërtohet dhe operohet nga katër kompani private.

E përkthyer në kilometra, fatura shkon në rreth 21.5 milionë euro për kilometër. Por jo e gjithë shuma është kosto ndërtimi.

Sipas dokumenteve të prokurimit, rreth 182.5 milionë euro parashikohen për ndërtimin dhe rehabilitimin ndërsa pjesa tjetër për projektimin, sistemin e pagesës, operimin dhe mirëmbajtjen gjatë 35 viteve. Vetëm ndërtimi llogaritet në rreth 10.7 milionë euro për kilometër.

Projekti përfshin edhe një tunel me dy tuba, secili rreth 850 metra, për anashkalimin e qytetit të Lezhës.

Fitues i garës së shpallur nga Ministria e Infrastrukturës është konsorciumi i kompanive “Salillari”, “ALB TIEFBAU” i Flamur Hoxhës, “InfraKonsult” e Redi Strugës dhe “ERALD-G” e Gëzim Ismailit.

Por mes emrave që do të zbatojnë kontratën 35-vjeçare, ka edhe persona që kanë përfunduar në dosjet e SPAK.

“ERALD-G” është në pronësi të Gëzim Ismailit, emri i të cilit është përmendur në hetimet për dosjen e njohur si “Grupi i Arubës”. Nënkryetari i Partisë Demokratike, Belind Këlliçi, ka deklaruar publikisht se Ismaili është përfshirë në hetimet që lidhen me dyshime për trafik ndërkombëtar droge dhe pastrim parash. Në qershor 2026 u raportua edhe për masa sigurie të vendosura në kuadër të kësaj dosjeje.

Bëhet fjalë për hetime në zhvillim dhe jo për një konstatim fajësie. Por nuk është i vetmi emër.

Edhe Redi Struga i “InfraKonsult” është përfshirë në veprimet hetimore të SPAK. Në qershor, Prokuroria e Posaçme urdhëroi kontrollë në kuadër të hetimeve për dyshime mbi tjetërsimin e pronave në Zvërnec.

Pra, dy prej kompanive të konsorciumit që do të ndërtojë dhe operojë Milot-Balldrenin lidhen me persona të përfshirë në çështje që ndodhen aktualisht nën hetim.

Ndërkohë jo të gjitha detajet e marrëveshjes janë bërë publike.

Në regjistrin e prokurimeve rezultojnë konsorciumi fitues dhe vlera e parashikuar prej afro 365 milionë eurosh, por mungojnë ende të dhëna të rëndësishme të kontratës, përfshirë vlerën përfundimtare të kontraktuar, ndarjen e pjesëmarrjes mes katër kompanive dhe planin financiar të ofertës fituese.

Milot-Balldren është ndërkohë një projekt që vjen me precedent.

Në vitin 2018, koncesioni iu dha A.N.K., por kontrata u zgjidh më pas për mosplotësim të kushteve të financimit.

Auditimet e KLSH-së për procedurën e parë evidentuan problematika në dokumentacionin financiar, përfshirë mospërputhje në shumat dhe afatet e financimit të deklaruar.

Tetë vite më vonë, Milot-Balldren rikthehet për herë të dytë. Dhe këtë herë, dy prej emrave të lidhur me kompanitë fituese janë njëkohësisht në vëmendjen e SPAK. (TCH)

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 18 Shtator 20:23

[Nga 1000-u te "gara e vdekjes", si humben jeten 3 te rinjte shqiptare ne Greqi](#)

Detaje të reja kanë dalë në dritë për aksidentin e rëndë të ndodhur në Glyfada të Athinës, ku humb&e...

AKTUALITET 18 Shtator18:06

[E rëndë në Skrapar! Foshnja transportohet drejt Traumës, dyshohet se ka dëmtuar dorën me grirëse mishi](#)

Një foshnje 1-vjeçare është transportuar me helikopter drejt Spitalit të Traumës në Tiranë, pasi dyshohet se ka dë...

AKTUALITET 18 Shtator17:23

[E rëndë në Itali/ Po shoqëronte vajzën për në shkollë, 42-vjeçarja shqiptare përplaslet për vdekje nga kamioni](#)

Një aksident i rëndë ka ndodhur në mëngjesin e sotëm në San Donà di Piave, pranë Venedikut, ku 42-vjeçarja...

AKTUALITET 18 Shtator17:13

[Alket Rizai ka hyrë në Shqipëri? Policia e Shtetit: Nuk kemi informacion zyrtar](#)

Pas pesë ditësh kërkimesh nga autoritetet greke, nuk ka ende asnjë gjurmë të Alket Rizait, i cili u arratis pas përfundimit t...

AKTUALITET 18 Shtator17:04

[Detaje/ Abuzimi i 12-vjeçares në Tiranë, 29-vjeçari pranon se kreu marrëdhënie me vajzën e dajës](#)

Detaje të reja kanë dalë në pah nga ngjarja e rëndë që dje shokoi mbarë opinionin publik pasi dy të rinj u vunë...

AKTUALITET 18 Shtator16:56

[Revolucioni Flamingo/ Eurodeputetët kërkojnë hetim ndaj Metës pas pezullimeve masive të llogarive në rrjetet sociale](#)

Eurodeputetët kërkojnë hetim ndaj Metës pas pezullimit masiv të llogarive që raportnin për protestat në ShqipëriLi...

AKTUALITET 18 Shtator16:30

[Përfshihet nga flakët një sipërfaqe toke në zonën e Katund Sukthit në Durrës, ndërhyjnë zjarrfikësit](#)

Një zjarr ka përfshirë pasditen e kësaj të premteje një sipërfaqe toke në zonën e Katund Sukthit, në Durr&eu...

AKTUALITET 18 Shtator15:55

[Kuvendi miratoi formulën e re të pagave, magjistratët nuk tërhiqen: Do e çojmë në Gjykatën Kushtetuese](#)

Shoqatat e gjyqtarëve dhe prokurorëve kanë kundërshtuar formulën e re të pagave të magjistratëve, të miratuar nga K...

AKTUALITET 18 Shtator15:51

[Largoi 950 mijë euro verëra nga vila e Ergys Agasit, lihet në burg Eno Agasi](#)

Gjykata ka lënë në burg kushëririn e Ergys Agasit, Eno Agasin, i akuzuar se ka larguar verëra me vlerë 950 mijë euro nga vila...

AKTUALITET 18 Shtator15:39

[Zjarr në një sipërfaqe me barishte në Durrës, shërbimi zjarrfikës i qytetit në luftë me flakët](#)

Një zjarr ka rënë në një sipërfaqe në Sektor Rinia në Durrës. Mësohet se shërbimi zjarrfikës i Du...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 18 Shtator

["Nëna e fëmijëve të mi, dashuria ime sot na la" ...](#)

Loer Kume, deputet i Partisë Socialiste për Durrësin dhe prozator e eseist i njohur, ka njoftuar mesditën e kësaj të premte ndar...

AKTUALITET 17 Shtator

[Këta janë tre të rinjtë nga Fieri që humbën jetë...](#)

Një aksident tragjik ka ndodhur në orët e para të mëngjesit në lagjen Glifadha të Athinës, ku kanë humbur jetë...

AKTUALITET 17 Shtator

[Ky është vendi i aksidentit tragjik ku humbën j...](#)

Kv është vendi ku tre të rini humbën jetën në aksidentin rrugor në rrugën Poseidonos në Greqi. ndër...

INVESTIGIME 17 Shtator17:59


[Tensionet te Kuvendi, shoqërohen në polici të paktën 25 protestues](#)

Të paktën 25 persona janë shoqëruar nga policia pas tensioneve të regjistruara gjatë protestës së zhvilluar sot pranë...

video




E premte | ? 20:45 | Syri TV







E premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV





Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.